**PROCES VERBAL**

Mbajtur sot me datë: 26.10.2022, ora 15:00 në Njësinë Administrative Gurrë, për hartimin e projekt- buxhetit 2023 dhe Paketës Fiskale 2023.

Marrin pjesë: Kryetari i Bashkisë, Nënkryetarja e Bashkisë, Administratori i Njësisë Administrative Gurrë, Drejtoresha e Burimeve Njerëzore, Çështjeve Juridike & Shërbimeve financiare.
Hap takimin kryetari i Bashkisë dhe tregon arsyen për të cilën jemë mbledhur d.m.th për të marrë kërkesat dhe mendimet e qytetarëve përpara hartimit të projekt buxhetit të vitit 2023 & paketës fiskale & për ti paraqitur këto kërkesa në buxhet.
Kryetari shpjegon mënyrën e financimit të bashkisë nga transferta e pakushtëzuar, transferta specifike, transferta e kushtëzuar & nga të ardhurat e mbledhura nga njësia e vetqeverisjes vendore.
Shpjegon paketën fiskale duke trajtuar llojet e taksave, tarifave, gjobave etj.
Kryetari paraqet në mënyrë të përmbledhur punët që janë bërë në këtë njësi administrative si: Shërbimet në ujësjellës, riparimet e kanaleve vaditëse, mirëmbajtjen e godinave shkollore, administrimin e rasteve të djegieve, mirëmbajtjen e rrugëve rurale etj.
Për Njësinë Administrative Gurrë problemet që duhen të marrin zgjidhje sa më parë paraqet: Urën e fshatit Dom dhe Ujësjellësin Gurrë e Vogël dhe Kripë.
Gjithashtu problem në këto fshatra janë edhe rruga nga Muhaxremi dhe Uji vaditës për fshatin Mishtër.
Shpjegon që për vaditjen janë bërë pastrim kanalesh, blerje tubash e çimento.
Në lidhje me situatën në për rrugët rurale Kryetari paraqet shqetësimin në lidhje me problemet e kësaj zone & terrenin e vështirë.
Kryetari sqaron të pranishmit që në aspektin social nuk janë bërë diferencime në dhënien e ndihmave financiare, ndihmave ekonomike, bonusit të gruasë etj.

Kryetari flet edhe për ujësjellësin e fshatit Shulbatër, i cili është bërë nga punonjësit e bashkisë, pa procedurë prokurimi.
Ai u drejtohet banorëve që të paraqesin kërkesat e tyre.
Merr fjalën Ahmet Qosja - Banori fshatit Mishtër.
Falenderon kryetarin & stafin për punët e bëra dhe për segmentet e reja që janë hapur.
Kërkesa e tij lidhet me kanalin vaditës për 2000 ml tubë dhe për 3 vende që të bëhen me çimento.
Merr fjalën Agim Pjetri (Zall Kripë)
Kërkon të dijë ndryshimin e buxhetit të vitit 2022 me buxhetin e vitit 2023.
Kryetari shpjegon që ndryshimi është për shkak të ndryshimit të transfertës nga viti në vit për shkak të ndryshimeve në paga, inflacioni, taxoit, tarifat vendore.
Agim Pjetri ka kërkesë për rrugë, ujë të pijshëm & ujë vaditës.
Merr fjalën Myrteza Gjini - banori fshatit Shulbatër, i cili falenderon Kryetarin për punët e bëra e sidomos ujësjellësin.
Flet Sami Baku - banori fshatit Kripë i cili falenderon për punët e bëra
Ka kërkesë për ujin vaditës (kanal & rezervuarin).
Altin Duka paraqet problemin e rrugës te Mehmet e Xhelajdin Kurti.
Kryetari shpjegon që duhen parë edhe rastet e konflikteve që janë me vendim Këshi Bashkiak.
Merr fjalën Hasan Disha dhe falenderon Kryetarin për punët e bëra në terren. Si ish punonjës (shofer kamioni e tani në pension) tregon të gjitha vështirësitë që ka kaluar edhe në hapjen e segmenteve të reja (të cilat i përmend me emra).
Flet Ahmet Karaj (banori fshatit Gurrë e Madhe, i cili falenderon për menaxhimin e ujit të pijshëm, mirëmbajtjen e kanaleve kulluese, pagesat e termetit. Ka kërkesë për 3000 m tubë për ujë vaditës nga (Pepa te Bajram Hoxha), të cilën Kryetari thotë që pasi të matet terreni do e sjellë tuben.
Kryetari mbyll fjalimin duke thënë që do ketë parasysh: Sifonin e Mishtrit dhe tuben për Gurrën e Madhe, sifonin për Zall Dom & 1 Km rrugë,

**Drejtor i B. Njerëzore, Ç. Juridike dhe Sh. Financiare**

Enduina Neli

Përgjegjëse e Financës

Silvana Bala